



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality**  
**DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM**



**Nr.13/89**

**Më: 04/02/2020**

**D r a g a s h**

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, neni 6 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komonale për Arsim në Dragash, shpall:

### **KONKURS-përsëritet**

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët të Komunitetit të Dragashit për vitin shkollor 2019/2020.

#### **SHFMU " Ilmi Bahtjari"- Blaç**

1. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zgatar

#### **SHFMU " Sezai Surroi"- Bellobrad**

1. Një edukatore për mësimin parafillor në paralelen e ndarë në Zym (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
2. Një mësimdhënëse për Gjuhë Gjermane (10 orë )

#### **I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.), Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës), Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj, Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar, Certifikata që nuk jeni nën hetime, Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka). Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë:04.02.2020  
Dragash

Drejtori i DKA-së  
MSc. Vloran Cenaj